

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7840  
E shtunë, 20 korrik 2024  
Çmimi 0.50 €

## Osmani takon Macronin, flasin për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike



FAQE 4

Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# AVARIA TEKNOLOGJIKE GLOBALE PREK EDHE KOSOVËN

FAQE 4



Një dështim në operacionet e një gjiganti teknologjik ka prekur punën e dhjetëra

agjencie të premtën, duke anuluar fluturimet, duke penguar transmetimet

televizive, si dhe punën nëpër spitale dhe banka. Avaria preku edhe Kosovën

## POLICIA SERBE VRET FATON HAJRIZIN

F.5



## IKD-ja: QASJA E LIGJIT TË RI TË KPM-SË ËSHTË E RREZIKSHME, CENON VLERAT DHE PARIMET E DEMOKRACISË

F.7

## EKIPI I BIDENIT THOTË SE AI NUK DO TË TËRHIQET NGA GARA

F.2

## SCHOLZI NË BEOGRAD: LITUMI ËSHTË PO AQ I RËNDËSISHËM SA NAFTA DIKUR

F.2

## KURTI VIZITOI VENDPUNIMET E RRUGËS KIJEVË - ZAHAQ, SEGMENTIN KIJEVË - DOLLÇ

F.3

## EKONOMI



## RRITJA E KËRKESËS PËR RRYMË "DO T'I MBAJË GJALLË TERMOCENTRALET ME THËNGJILL"

F.8

## PËR REALIZMIN E PROJEKTIT 'JETA' JEPEN 16 MILIONË DOLLARË

F.8

## SPORT



## NISIN GARAT 'FIBA 3X3 CHALLENGER' NË PRISHTINË

F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Scholzi në Beograd: Litiumi është po aq i rëndësishëm sa nafta dikur

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë të premten në Beograd se projekti Jadar, i cili parasheh krijimin e një miniere litiumi në pjesën perëndimore të Serbisë, është gjë e mirë për këtë vend.

Scholzi dhe zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Marosh Shefçoviç, kanë theksuar se gjatë mihjes së këtij minerali të rëndësishëm do të respektohem standardet më të larta për ambientin.

Të dy zyrtarët kanë folur për përfitimet e projektit për mihje të litiumit, teksa presidenti serb Aleksandar Vuçiq është përballur me kundërshtimet e ambientalistëve dhe banorëve të zonës, të cilat kanë shqetësime për mjedisin.

Përgjatë Samitit për Lëndët e Para të Qëndrueshme në

Beograd, blloku evropian dhe Serbia kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për partneritet strategjik lidhur me lëndën e parë të qëndrueshme, rrjetin e prodhimit të baterive dhe makinave elektrike.

Ky takim ka ndodhur pak ditë pasi Qeveria e Serbisë e ka rishikuar projektin Jadar, i cili parasheh hapjen e një miniere të litiumit në luginën e Jadrës në Serbi nga gjiganti botëror "Rio Tinto".

Scholzi ka thënë në një konferencë të përbashkët me Shefçoviçin dhe Vuçiqin se Jadar është projekt evropian.

Sipas kancelarit gjerman, litiumi do të jetë po aq i rëndësishëm për lëvizshmërinë në të ardhmen, ashtu sikurse ka qenë nafta deri më tani. Ai ka thënë se projekti është pozitiv për shumë



arsye, përfshirë rritjen e perspektivës dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Serbi. "Vendimi kërkon kurajë. Po marrim një hap të rëndësishëm, duke nxjerrë

litium në Serbi ne mund t'i përmbushim synimet për klimën", ka thënë Scholz, duke shtuar se "kemi nevojë për bateri". Bashkimi Evropian është duke

tentuar ta zvogëlojë varësinë ndaj importeve të Kinës, derisa Gjermania është prodhuesja më e madhe e makinave elektrike në Evropë, të cilat funksionojnë me bateri të litiumit.

Vuçiqi ka thënë pas nënshkrimit të memorandumit se është i lumtur "për atë që ka nisur sot". "Kjo është e rëndësishme për Evropën, për Gjermaninë, mirëpo për neve në Serbi është ndoshta me më së shumti rëndësi. Kjo përbën pikë kthese dhe mundësi të madhe për ne", ka thënë Vuçiq.

Ai ka thënë se bashkëbiseduesve nuk ua ka fshehur vështirësitë me të cilat përballet Qeveria e Serbisë për mihjen e litiumit. Presidenti serb ka thënë se Serbia do të insistojë në mbrojtje të ambientit, duke e konsideruar "aspekt thelbësor".

## Ekipi i Bidenit thotë se ai nuk do të tërhiqet nga gara

WASHINGTON, 19 KORRIK - Fushata e presidentit amerikan Joe Biden insistoi sërish se ai nuk do të tërhiqet nga gara edhe pse shumë demokratë të nivelit të lartë duan që ai ta shqyrtojë mundësinë që të largohet nga gara për zgjedhjet presidenciale të nëntorit, për t'i hapur rrugën një kandidati të ri demokrat për të parandaluar një humbje të mundshme në zgjedhje. Bideni aktualisht gjendet në shtëpinë e tij në Dellauer ku është izoluar për shkak të infektimit me koronavirus.

Presidenti amerikan ka insistuar se mund ta mposhtë republikanin Donald Trumpin, teksa po përballet me presion që ta lërë garën.

Shefja e fushatës së Bidenit, Jen O'Malley Dillion, e pranoi se ka "rënie" të mbështetjes për presidentin, por insistoi se ai



"absolutisht" do të qëndrojë në garë dhe se fushata e tij "ka disa rrugë" për ta mposhtur Trumpin. "Ne kemi shumë punë për të bërë për ta siguruar popullin amerikan se po, ai është i vjetër, por mund të fitojë", tha ajo për MSNBC. Ajo tha se shqetësimet e votuesve për

aftësinë e Bidenit për të udhëhequr me shtetin nuk po i bëjnë ata që të votojnë për Trumpin. "Ata kanë pyetje, por ata po qëndrojnë me Joe Bidenin", shtoi ajo. Në të njëjtën kohë, Komiteti Kombëtar i Partisë Demokratike pritet të takohet të premten për ta

shtyrë përpara votimin e planifikuar virtual para 7 gushtit, ku pritet të nominohet kandidati i partisë për president. Kjo mbledhje virtuale do të mbahet para se partia ta mbajë Kuvendin më vonë gjatë gushtit në Çikago.

Një shumicë e demokratëve mendojnë se nënpresidentja Kamala Harris mund të jetë një kandidate e mirë për presidente. Sipas një sondazhi të realizuar nga Associated Press dhe NORC Center for Public Affairs Research, gjashtë në dhjetë demokratë besojnë se Harris do të ishte një presidente e mirë. Dy në dhjetë demokratë besojnë se ajo nuk do të ishte një presidente e mirë dhe dy në dhjetë të tjerë nuk kanë mendim.

Demokratët në nivelet më të larta i kanë kërkuar Bidenit ta shqyrtojë kandidaturën e tij. Në mesin e tyre raportohet se edhe ish-presidenti

Barack Obama ka shprehur shqetësime për kandidaturën e Bidenit dhe ish-kryerja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, raportohet se privatisht i ka thënë presidentit se partia mund ta humbë aftësinë që ta marrë kontrollin e Dhomës nëse ai nuk tërhiqet nga gara presidenciale.

E të mërkurën ligjvënësi i Kalifornisë, Adam Schiff, një aleat i ngushtë i Pelosit, u bë demokati i profilit më të lartë në Dhomën e Përfaqësuesve, që i bëri thirrje Bidenit të tërhiqet nga gara.

Shqetësimet për aftësinë e Bidenit për të udhëhequr shtetin edhe për një mandat u rritën pas debatit presidencial me Trumpin më 27 qershor. Vetë Bideni e ka pranuar se nuk ka pasur performancë të mirë gjatë debatit, por që atëherë ka refuzuar thirrjet për t'u tërhequr nga gara.

## Zelensky kërkon unitet pas "misionit për paqe" të Orbanit

KIEV, 19 KORRIK - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka refuzuar bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje me Rusinë pa miratimin e Kievit, pasi kryeministri hungarez Viktor Orban u takua me presidentin rus, Vladimir Putin, teksa forcat ukrainase po vazhdojnë të luftojnë pushtimin e nisur nga Rusia.

Zelensky mori pjesë në Samitin e Bashkësisë Politike Evropiane të mbajtur në Pallatin Blenheim në Mbretërinë e Bashkuar. Me të arritur në samit, Zelensky

menjëherë u kërkoi të pranishmëve që të "mbajnë unitetin në Evropë sepse gjithmonë uniteti çon në marrjen e vendimeve të fuqishme".

Deklaratat e Zelenskyt vijnë pasi Orban - që po ashtu mori pjesë në samit - ndërmori atë që ai e cilësoi si "mision të paqes", kur vizitoi Moskën, Kievin, Pekinin dhe më pas Floridën, ku u takua me ish-presidentin amerikan Donald Trump.

Këto vizita zemëruan shumicën e liderëve evropianë, të cilët u distancuan nga vizitat

e Orbanit, teksa lideri hungarez e ka pranuar se ai nuk ka autoritet të veprorë në emër të shteteve të tjera të Bashkimit Evropian, edhe pse Hungaria aktualisht udhëheq presidencën e bllokut. "Nëse dikush në Evropë tenton t'i zgjidhë çështjet prapa krahëve të të tjerëve, nëse dikush dëshiron të bëjë vizita në kryeqytetin e luftës apo të flasë, ndoshta duke u premtuar diçka që është kundër interesave tona të përbashkëta apo në kurriz të Ukrainës apo shteteve të tjera,



pse ne duhet ta marrim parasysh një person të tillë", tha Zelensky gjatë samitit më

18 korrik. "BE-ja dhe NATO-ja mund t'i adresojnë interesat e tyre pa këtë person", shtoi ai.



# IKD-ja: Qasja e ligjit të ri të KPM-së është e rrezikshme, cenon vlerat dhe parimet e demokracisë

EPOKA  
ERE


Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ligji për Komisionin e Pavarur për Media shkatërron tërësisht pavarësinë kushtetuese të këtij institucioni, duke e shndërruar këtë institucion në një institucion vartës të Kuvendit dhe lehtë të ndikueshëm nga qeveria. Kështu është theksuar në raportin "Politizimi i KPM-së" nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) përmes analizës të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve, të cilin Kuvendi i Kosovës e miratoi më 11 korrik 2024.

Hulumtuesi në IKD, Florian Smajli, ka thënë se nga gjetjet që kanë realizuar vërehet se kjo qasje e ligjit të ri të KPM-së është e rrezikshme dhe cenon drejtpërdrejt vlerat dhe parimet e demokracisë të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu nga gjetjet, Smajli ka thënë se IKD-ja ka gjetur se rritja e numrit të anëtarëve është një vendim i pambështetur në një analizë reale dhe nuk përkon me

nevojën e funksionimit adekuat të KPM-së. "Ky ligj shkatërron tërësisht pavarësinë kushtetuese të këtij institucioni duke e shndërruar si një institucion vartës të Kuvendit dhe që është lehtë i ndikueshëm edhe nga qeveria. IKD-j konsideron se kjo qasje e ligjit të ri të KPM-së është e rrezikshme dhe e cenon drejtpërdrejt vlerat dhe parimet e demokracisë të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Duke u nisur se ky ligj nuk ka pasur përkrahje as nga faktorët ndërkombëtarë, shoqëria civile, medie, opozita, kjo mënyrë e veprimit tregon qartazi se miratimi i këtij ligji ishte vullnet vetëm i pozitës. IKD-ja ka gjetur se rritja e numrit të anëtarëve është një vendim i pambështetur në një analizë reale dhe nuk përkon me nevojën e funksionimit adekuat të KPM-së", ka thënë ai.

Ndërsa hulumtuesi i lartë në IKD, Gzim Shala, ka theksuar se politizimi i KPM-së ndodh përmes këtij projektligji, derisa ka shtuar se miratimit të këtij ligji i ka paraprirë një fushatë e



egër ndaj KPM-së, ku eksponentë të partisë politike në pushtet i kanë akuzuar edhe për tradhti kombëtare. Ndërsa ka shtuar se nëse i njëjti do të shkonte te presidentja për dekretim, presidentja do të duhej ta aplikonte të drejtën e

saj kushtetuese për kthimin e projektligjit në Kuvend. "E kemi parasysh se nëse ky projektligj do të shkonte te presidentja e vendit për dekretim, do të duhej ta aplikonte të drejtën e saj kushtetuese për kthimin e projektligjit në Kuvend, mirëpo

dje ky projektligj ka shkuar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese dhe, sipas ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullores së Punëve të Kuvendit, projektligji në fjalë nuk ka shkuar fare te presidentja", ka thënë Shala.

## Statuti i UP-së kushtetuese, Nagavci: Ndryshimet e mëdha në UP e kanë prishur rehatinë e atyre që dikur e kontrollonin

PRISHTINË, 19 KORRIK - Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës të enjten ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për ndryshimin e statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", akt ky i miratuar në seancën e fundit të Kuvendit të Kosovës.

Ndaj këtij veprimi ka reaguar ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, e cila ka thënë se kjo konfirmim edhe një herë se ndryshimet e mëdha e pozitive që janë bërë së fundi në universitet kanë prishur rehatinë e atyre që dikur kanë kontrolluar vendimmarrjen në UP.

Ajo ka thënë se justifikimet e këtyre subjekteve si pretekst për



mospjesëmarrje në votim të statutit të UP-së janë mbulim i arsyes së vërtetë që lidhet me kriteret drejt cilësisë të vendosura

në këtë statut. "Si Ministri e Arsimit dhe si qeveri kemi përkrahur Universitetin drejt ndryshimeve përbajtësore që janë bërë si në

Statut së fundi ashtu edhe në secilën çështje tjetër drejt vetregullimit dhe avancimit të performancës. Veprimi i PDK-së është natyrisht në vazhden e luftimit dhe sabotimit të vullnetit qytetar dhe reformave shtetërore të ndërmarra në shumë sektorë. Po ashtu, dërgimi i statutit cenon rëndë autonominë e universitetit sikurse është tentativë për rikthimin e UP-së hapa pas ku ishte. Kriteret e standardet në statut janë të vendosura nga vet universiteti që ka kaluar nëpër një mori nivelesh nga Komisioni Profesional e gjithëpërfshirës deri te hallkat vendimmarrëse në Universitet si Senati dhe Këshilli Drejtues", ka shkruar Nagavci në "Facebook".

Ministrja ka thënë se Universiteti i Prishtinës do ta fitojë edhe këtë betejë dhe ngadalë por sigurt do të kthehet aty ku e ka vendin, universitet me autonomi, akademi, integritet dhe kredibilitet. "Vend ku do të prodhohen kadro cilësore e klanet joprofessionale dhe joparimore nuk do të kenë vend më", ka theksuar Nagavci.

Sa i përket vendimit për statutin e UP-së, kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se përmes tij synohet cenimi i marrëdhënies së punës së stafit akademik të UP-së, duke i vendosur përballë situatave të presioneve dhe kërcënimeve të pabaza për humbjen e titujve akademikë e, për rrjedhojë, edhe të marrëdhënies së punës.

## Kurti vizitoi vendpunimet e rrugës Kijevë - Zahaq, segmentin Kijevë - Dollc


PRISHTINË, 19 KORRIK - I shoqëruar nga ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe zëvendësministri i këtij dikasteri, Hysen Durmishi, si dhe zëvendësministrat Taulant Kelmendi dhe Mentor Arifaj, kryeministri Albin Kurti, të premten vizitoi vendpunimet e rrugës Kijevë - Zahaq, segmenti

Kijevë - Dollc. Ai u njoftua nga menaxherët e kontratave të tre loteve të këtij segmenti mbi ecurinë e punimeve. Kryeministri përshëndeti edhe falënderoi punëtorët dhe kompanitë për punën që po e bëjnë në realizimin sa më të shpejtë të këtij projekti infrastrukturor me rëndësi të madhe për rajonin e Pejës.

Në javën e parë të muajit korrik u hapën procedurat për dorëzimin e ofertës për ndërtimin e Rrugës Nacionale N9 Kijevë - Zahaq, përkatësisht segmenti Dollc - Zahaq. Segmenti i kësaj rruge ka gjatësi totale 16.27km, e ndarë në 4 lote, me buxhet të planifikuar të projektit prej rreth 46 milionë eurosh.







## Avaria teknologjike globale prek edhe Kosovën

Një dështim në operacionet e një gjiganti teknologjik ka prekur punën e dhjetëra agjencive të premtën, duke anuluar fluturimet, duke penguar transmetimet televizive, si dhe punën nëpër spitale e banka. Avaria preku edhe Kosovën

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Kompania globale "Crowdstrike" ka thënë se problemet kibernetike që janë shkaktuar të premtën në gjithë botën janë pasojë e një "defekti" gjatë përditësimit të një sistemi të saj. Kjo kompani krijon softuerë për t'i luftuar viruset kompjuterike. "Crowdstrike" ka thënë se është duke punuar vazhdimisht me konsumatorët. "Sistemet Mac dhe Linux nuk janë prekur. Ky nuk është incident i sigurisë apo sulm kibernetik. Problemi është identifikuar, izoluar dhe po punohet në të", ka thënë kompania përmes një deklaratë.

Shumë kompani të mëdha ajrore në Shtetet e Bashkuara i kanë anuluar fluturimet, duke cituar probleme me komunikim, derisa kompani të tjera mediale, banka dhe spitale në shumë vende të botës, kanë raportuar që kanë probleme me sistemet kompjuterike dhe që po u pamundësohet puna. Në Kosovë, Kompania për Furnizim me Energji Elektrike e Kosovës (KESCO) ka bërë me dije se qysh prej mëngjesit është duke hasur në vështirësi pë kryerjen e punëve për shkak të rënies së sistemit kompjuterik. Ajo e ka përmendur që

### Situata me fluturime në Evropë

Në faqen e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" është parë që disa fluturime janë anuluar ose janë shtyrë. Aeroporti në Berlin ka paralajmëruar që vonesa në fluturime do të ketë gjithë ditën. Zëdhënësi i Aeroportit të Cyrihut ka thënë se nuk ka probleme, por fluturimet për Berlin i ka anuluar për shkak të problemeve atje.

Kompania e fluturimeve "Lufthansa" ka thënë se operacionet e saj janë prekur pjesërisht dhe se mund të ketë anulime apo vonesa në fluturime. "Air Franc" ka raportuar, gjithashtu, se fluturimet e kompanisë janë prekur si pasojë e problemeve me kompani të tjera në gjithë botën. Ngjashëm edhe linja holandeze KLM.

problemët e saj lidhen me problemin që e kanë raportuar shumë kompani në botë, të lidhur me "Crowdstrike". Disa qytetarë në Kosovë i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se

rreth orës 9:45 të së premtes nuk kanë arritur të tërheqin para të gatshme në disa banka të Kosovës. Por më vonë, rreth orës 12:00, bankomatet kanë funksionuar.

Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike, organ shtetëror për ruajtjen e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Kosovë, ka thënë se incidenti shkaktonte probleme gjatë ristartimit të sistemit operativ Microsoft Windows. "Në rast të këtij problemi, sipas udhëzimeve teknike të proklamuar deri më tani, është e nevojshme që të fshihen fajllat 'C-00000291\*.sys' nga direktori i 'C:\Windows\System32\drivers\CrowdStrike' në Save Mode", ka thënë ky organ përmes një postimi në Facebook. Sa iu përket vendeve të tjera: Në Kroaci raportohet të ketë rënë Sistemi Qendror Informativ Shëndetësor. Televizioni britanik "Sky News" ka qenë për pak kohë jashtë transmetimit. Policia në shtetin amerikan të Alaskës ka raportuar për bllokim të linjës për emergjencë - 911.

### Hoti thotë se Qeveria ka dështuar në të gjitha premtimet e dhëna për shëndetësi

**PRISHTINË, 19 KORRIK** - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë disa kritika mbi Qeverinë Kurti, duke thënë se ka dështuar të realizon premtimet e bëra. Hoti pohon se Qeveria Kurti ka dështuar në të gjitha premtimet në shëndetësi, përmes të cilave e kanë kërkuar besimin e qytetarëve në 2021. "Kanë dështuar në të

gjitha premtimet në shëndetësi, përmes të cilave e kanë kërkuar besimin e qytetarëve në 2021. Dy projektet madhore në shëndetësi janë lënë anash: Sistemi i Informimit Shëndetësor nuk është funksionalizuar. Sigurimet Shëndetësore nuk kanë nisur ende", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka treguar se çfarë thotë

edhe auditimi i brendshëm për furnizimin me barna. "Nuk ka planifikim adekuat për furnizim me barna esenciale, vetëm gjysma e barnave të parapara sigurohen, pak mbi gjysma e materialit medicinal sigurohet, disa reparte nuk mbajnë evidencë për shpenzimin e barnave, gjatë vitit 2023 ka pasur blerje të barnave jashtë listës esenciale,

dhe këto blerje në disa klinika nuk regjistrohen. Buxheti mbetet shumë i ulët, me vetëm 260 dollarë për kokë banori, krahasuar me 4,000 dollarë për vendet e OECD-së. Emigrimi i stafit shëndetësor është rritur me 50% nga viti 2021 e këndej. Mbi 800 mjekë kanë emigruar. Ligji i pagave nuk ka zgjidhur asgjë. Pagat janë devaluuar nga inflacioni i lartë. Investimet kapitale në



shëndetësi kanë qenë të papërfillshme", ka shkruar Hoti.



# Policia serbe vret Faton Hajrizin

PRISHTINË, 19 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Serbisë, njëherësh ministër i Punëve të Brendshme, Ivica Daçiç, ka thënë të premten se është vrarë personi që në orët e para të së enjtes vrau një polic në Serbi. Identiteti i personit të vrarë nuk është përmendur në komunikatën e lëshuar nga autoritetet serbe në pasditen e 19 korrikut, por nga familjarët e Fatonit është konfirmuar se ai

është vrarë.

Mediet në Serbi kanë publikuar edhe fotografi të trupit të viktimës.

Daçiç gjatë së premtes tha se autoritetet ishin në kërkim të Faton Hajrizit, i dyshuar për vrasjen e policit dhe plagosjen e një tjetri në Lloznicë, qytet në pjesën perëndimore të Serbisë. Vrasja e policit Nikolla Kërmanoviq ka ndodhur në orët e para të së enjtes kur

policia e ka ndalur veturën në të cilën ka qenë i dyshuari për një kontroll rutinor.

Që nga 6 korriku, Faton Hajrizi, shtetas i Kosovës, kishte qenë në kërkim nga autoritetet e Kosovës, pasi ishte arratisur nga burgu i Smerkonicës.

Hajrizi dyshohet se kishte udhëtuar nëpër Serbi me dokumentet e vëllait, Artanit, të cilat janë gjetur në vendngjarje pas vrasjes së policit serb.

Ndërkohë, Artani është paraqitur para autoriteteve në Gjermani, ku dhe jeton, duke theksuar se i vëllai, Fatoni, ia kishte vjedhur pasaportën gjatë kësaj jave në Gjermani. Megjithatë, nuk është konfirmuar nëse Fatoni ka qenë në Gjermani.

Ministria e Brendshme e Serbisë, më herët gjatë së premtes, po ashtu publikoi fotografinë e Faton Hajrizit dhe u bëri thirrje

qytetarëve për bashkëpunim.

Autoritetet kryen kontrollet në dy anët e lumit Drina, që gjendet në kufi me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën, pasi dyshonin se personi që kreu vrasjen mund të ishte nisur në atë drejtim, raportoi Radio Televizioni i Serbisë (RTS) më 19 korrik. Sipas ndihmësdrejtorit të policisë Dragan Vasileviq, helikopterët dhe dronët u përfshin në kërkim të tij.



## Osmani takon Macronin, flasin për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike

PRISHTINË, 19 KORRIK - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, të enjten ka takuar presidentin francez Emmanuel Macron.

Osmani takoi presidentin francez gjatë qëndrimit të saj në Britani të Madhe për Samitin e katërt të Komunitetit Politik Evropian (EPC). "Dje, me presidentin Macron, diskutuam mbi rëndësinë e ecjes përpara drejt integritit të plotë të Kosovës në strukturat euroatlantike, në partneritet me aleatët tanë dhe

në dobi të të gjithë qytetarëve tanë, pa dallim", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Osmani ka njoftuar se diskutim përmbajtjesor ka pasur edhe me kryeministrin e ri të Holandës, Dick Schoof, për forcimin e partneritetit midis Kosovës dhe Holandës, si dhe për rëndësinë e avancimit të rrugës së Kosovës drejt institucioneve euroatlantike dhe anëtarësimit në organizata të tjera ndërkombëtare.





## Edhe 128 serra do t'u shpërndahen fermerëve në Gjilan

**GJILAN, 19 KORRIK** - Po vazhdon mbështetja e fermerëve të komunës së Gjilanit nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. 128 serra do t'u shpërndahen përfituesve. "Nënshkrimi i kontratave për 128 serra 100 m<sup>2</sup> nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë-Islamic Relif me fermerët nga Komuna e Gjilanit po vazhdon", ka njoftuar Bajram

Isufi, drejtor i Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Ai ka treguar se ky projekt pritet të finalizohet shumë shpejt me montimin e strukturës dhe materialit transparent të serrave të fermerët përfitues. Sipas tij, për më shumë se dy vjet e gjysmë qeverisje, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka mbështetur sektorin e hortikulturës dhe

fermerët kultivues të perimeve me mbi 200 serra të dimensioneve të ndryshme. "Drejtoria e Bujqësisë do të jetë afër fermerëve edhe këtë vit në formë të ndryshme si mbështetje direkte, trajnime dhe këshilla të ndryshme si dhe rregullim të infrastrukturës së të bërit bujqësi", ka thënë drejtori Isufi.



## Mbahet takimi i pestë i Këshillit Publiko-Privat në Rahovec, dëgjohej kërkesat e bizneseve

**RAHOVEC, 19 KORRIK** - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, bashkë me Jennifer N. Ober, drejtoreshë e Projektit për Qeverisjen e Pronës, kanë mbajtur takimin e pestë të Këshillit Publiko-Privat në kuadër të "Muajit të mërgimtarëve" 2024. "Së bashku me bizneset, përfshirë ato të mërgatës dhe në pronësi të grave, diskutuam rreth listës së pronave komunale për shfrytëzim dhe prezantuam hartat zonale për arritjen e qëllimeve afatgjata dhe adresimin e nevojave të këtij komuniteti. Bizneset, në anën tjetër, parashtruan kërkesat e tyre dhe si partnerë strategjikë, u diskutuan mundësitë potenciale për investim", ka njoftuar kryetari Latifi.

Ai ka bërë me dije se Këshilli Publiko-Privat u themelua në vitin 2022 dhe funksionon si një mekanizëm konsultativ joformal dhe këshillëdhënës për komunën që drejton, ku bizneset ndajnë përvojat dhe kërkesat e tyre. "Me këtë rast iu bëra ftesë bizneseve vendore dhe atyre nga mërgata për investime në komunën e Rahovecit, duke mirëpritur bashkëpunimin dhe sugjerimet e bizneseve në të ardhmen", ka thënë Latifi.

Kjo ngjarje u organizua në bashkëpunim me aktivitetin e USAID "Qeverisja e Pronës".



## Komuna e Drenasit nënshkruan memorandum me Agjencinë Kadastrale



**DRENAS, 18 KORRIK** - Nënkryetari i komunës së Drenasit, Arben Shala, ka marrë pjesë në një takim të rëndësishëm me drejtorin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti dhe me kryetarë të komunave. Në këtë takim u nënshkrua memorandum i cili ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi të ngushtë për implementimin e Kapitullit VII, i cili parashikon rindërtimin e Kadastrës. Ky memorandum përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt

përmirësimit të infrastrukturës kadastrale në komunën e Drenasit dhe në gjithë Kosovën.

Kapitulli VII synon ta rrisë efikasitetin dhe transparencën në administrimin e tokës, duke lehtësuar proceset për qytetarët dhe bizneset.

Rindërtimi i Kadastrës është esencial për zhvillimin ekonomik dhe urbanistik të komunës. Ky projekt do të sjellë lehtësira për qytetarët e Drenasit, duke përmirësuar qasjen në informacionet e pronës dhe duke

siguruar një menaxhim më të mirë të resurseve tokësore.

Drejtori i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Avni Ahmeti, ka theksuar se bashkëpunimi me komunat është thelbësor për suksesin e iniciativave të tilla dhe për zhvillimin e një sistemi të avancuar kadastral në Kosovë.

Takimi përfundoi me nënshkrimin e memorandumit, duke shënuar fillimin e një periudhe të re bashkëpunimi dhe zhvillimi në fushën e administrimit të tokës në Kosovë.

## Fillon renovimi i tërësishëm i katit të parë të objektit të administratës komunale në Prizren

**PRIZREN, 19 KORRIK** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqit Totaj, ka bërë me dije se ka filluar renovimi i tërësishëm i

katit të parë të objektit të administratës komunale, të cilat punime po zhvillohen me intensitet të lartë për

përmirësimin e kushteve të punës për zyrtarët komunalë. "Ky ndryshim do të ndihmojë në organizimin më efikas të

hapësirave dhe në përmirësimin e efikasitetit të punës në përgjithësi", ka shkruar Totaj në "Facebook".





## Një person dënohet me 12 vjet burgim për krime lufte ndaj civilëve në Kosovë

PRISHTINË, 19 KORRIK - Gjykata Themelore e Prishtinës ka dënuar me 12 vjet burgim Ekrem Bajroviqin për krime lufte kundër popullatës civile. Sipas gjykatës, që e ka identifikuar të dënuarin vetëm me inicialet e emrin të tij, ai është shpallur fajtor për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile shqiptare në fshatrat Staradran, Zallc, Gurrakoc dhe fshatrat e tjera përreth komunës së Istogut. Ai gjatë luftës kishte qenë polic i Serbisë në Stacionin e Policisë në Gurrakoc. Sipas njoftimit, më 7 dhe 8 maj të vitit 1999, gjatë një aksioni të forcave ushtarake, paramilitare dhe policore kundër popullatës civile shqiptare në këto fshatra, civilët u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe u urdhëruan të niseshin drejt Shqipërisë. I akuzuari, sipas gjykatës, ndau burrat dhe gratë nga kolona e nisur drejt Shqipërisë, duke i plaçkitur dhe

më pas forcat serbe i dërguan në një shtëpi në Staradran, duke i "pushkatuar të paktën 16 civilë të nacionalitetit shqiptar". Gjykata Themelore tha se më 7 maj të 1999-s Bajroviq kishte marrë pjesë në "arrestimin dhe keqtrajtimin e 84 civilëve të nacionalitetit shqiptar, ashtu që fillimisht të dëmtuarit (burrat) i ndajnë nga kolona tjetër e civilëve, u marrin të gjitha paratë dhe sendet e tjera me vlerë e pastaj që të gjithë i dërgojnë në Gurrakoc në lokalitë të Sh. S., ku i kishin maltretuar dhe torturuar në mënyrë çnjerëzore". Ndërsa më 8 maj 1999, sipas njoftimit, të ndaluarit i kishin dërguar në stacionin policor në Gurrakoc, "ku kolonës i printe i akuzuari E. B". Bajroviqit në kuadër të dënimit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, pra nga 19 tetori i vitit 2022. Ai ka të drejtë ta apelojë vendimin. Për vendimin e Gjykatës



Themelore ka reaguar anëtari i Frontit Demokratik pro-rus, Millan Knezheviq, i cili kërkoi që Parlamenti i Malit të Zi të dërgojë një notë proteste kundër vendimit. "Jo vetëm për t'u dërguar notë proteste institucioneve të përkohshme të Kosovës, por për t'i dërguar një

sinjal të qartë familjes Bajroviq dhe të gjithë qytetarëve malazezë se do t'u ofrojmë mbështetje institucionale për të vërtetuar një aktakuzë farsë", tha ai. Partia e tij nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Knezheviq tha se aktakuza ndaj

Bajroviqit ishte e "fabrikuar". Kryetari i Kuvendit, Andrija Mandiq, një nga liderët e Frontit Demokratik, tha se Mali i Zi e ka për obligim të kujdeset për qytetarët e tij "të cilët gjenden në një situatë kaq të vështirë". Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore. Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë më shumë se 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

## Fillon punimet Seminari XVII Mbarëkombëtar me Mësuesit e Gjuhës Shqipe dhe të Kulturës Shqiptare në Diasporë



PRISHTINË, 19 KORRIK - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, kanë organizuar Seminarin XVII Mbarëkombëtar me Mësuesit e Gjuhës Shqipe dhe të Kulturës Shqiptare në Diasporë, me temën "Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës

shqiptare në diasporë e në mërgatë". Kryeministri Albin Kurti me rastin e hapjes së punimeve ka thënë se ndihet i nderuar që gjendet para pjesëmarrësve për të uruar mbarëvajtjen e Seminarit të XVII të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare, ndërsa shtoi se populli i Kosovës është falënderues për ndihmën që ka dhënë diaspora për atdheun, në

veçanti për çlirimin e tij. Kryeministri Kurti vlerësoi kontributin e studentëve shqiptarë të cilët kanë arritur që gjuhën shqipe ta shohin si lëndë mësimore në Universitetin e Harvardit. Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, me këtë rast tha se pjesëmarrja në këtë ceremoni është emocion i veçantë, duke ditur misionin fisnik të mësuesve për ruajtjen dhe përhapjen e arsimit shqip në botë,

dhe përçimin e vlerave të çmuara të gjuhës sonë amtare. Nagavci theksoi se për 17 vjet me radhë mësuesit e gjuhës shqipe në botë kanë shkëmbyer përvojat e sfidat, arritjet e pengesat në këtë Seminar, ndërsa qeveria ka qenë përherë krah tyre për të dëgjuar rreth punës që ata bëjnë, për të parë se si mund të forcohen lidhjet dhe si mund të bëhet më shumë për të promovuar e kultivuar gjuhën dhe

kulturën tonë shqiptare në diasporë. Nagavci bëri me dije se Ministria e Arsimit e Kosovës ka shtuar dukshëm mbështetjen për komunitetet shqiptare në botë në shumë forma, duke përfshirë mes të tjerash: hartimin e kurrikulave dhe teksteve të përbashkëta, organizimin e aktiviteteve siç është ky Seminar, rritjen e mbështetjes për Seminarin e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqipe që organizohet çdo verë nga Universiteti i Prishtinës, mbështetjen e ekskursioneve nga nxënësit e Diasporës sonë në trevat shqiptare dhe fuqizimin e diasporës akademike me anë të platformave KRIS dhe KREN. Ministria e MPJD-së, Donika Gërvalla, tha se ky "përkushtim i juaji është dëshmi e qartë e lidhjes suaj të pashuar me Kosovën". Ajo theksoi se së bashku me Qeverinë e Shqipërisë dhe qeveritë e shteteve të tjera ku ka shqiptarë, përmes seminareve të tilla marrim impute të vlefshme për të kuptuar nevojat konkrete dhe sfidat me të cilat përballen mësuesit tanë në Diasporë. Kryetari i Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi, Blerim Ileshi, ka thënë se është gjithmonë kënaqësi vizita në Kosovë, e cila ruajtjen e gjuhës dhe kulturës e ka mbrojtur gjithmonë me çmimin më të lartë. Në fund të ceremonisë, ministria Nagavci ka dhënë mirënjohje për kontribuuesit institucionalë për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, Ymer Avdiu dhe Nuhi Gashi.



## BQK-ja: Sistemi ndërbanar i pagesave është plotësisht funksional

PRISHTINË, 19 KORRIK - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se Sistemi Ndërbanar i Pagesave (SNP), i cili është një sistem kombëtar i pagesave, është plotësisht funksional dhe nuk ka pasur asnjë ndërprerje në aktivitetin e tij. Ky njoftim bëhet për t'i informuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë përdoruesit e shërbimeve bankare, pas lajmit se edhe në këtë

institucion ka pasur sulme kibernetike. "Megjithatë, disa nga shërbimet online të ndonjë banke të caktuar janë ndikuar pjesërisht nga problemet globale me shërbimet e kësaj natyre. Në atë rast, edhe këto shërbime po rikthehen gradualisht nga banka, pa asnjë pasojë. BQK bën me dije se nuk ka pasur sulme kibernetike në sistemin bankar dhe nuk ka pasur asnjë

rrezik për të dhënat apo sistemet. Si pasojë e disa ndryshimeve teknike të aplikuara nga ofrues global të shërbimeve, disa nga shërbimet online janë kufizuar për një kohë të caktuar. Sistemi bankar është funksional dhe nuk ka asnjë arsye për shqetësim. Shërbimet bankare po ofrohen nga bankat përmes kanaleve të tyre fizike dhe digjitale", ka njoftuar BQK-ja.



## Për realizmin e projektit 'Jeta' jepen 16 milionë dollarë

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka takuar përfaqësuesit e MCA Kosovë, me të cilët ka diskutuar për projektin 'Jeta' dhe planet për fillimin e implementimit të tij, i cili projekt realizohet në kuadër të Programit Kompakt me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit.

Për realizmin e projektit 'Jeta', janë të dedikuara 16 milionë dollarë nga programi më i madh i energjisë me MCC-në. Ky projekt ka dy objektiva kryesore, ta nxisë trajnimin dhe shkathhtësinë e të rinjve, të cilët mund të kontribuojnë në sektorin e energjisë apo sektorë të ngjashëm, si dhe ta rrisë pjesëmarrjen e grave në sektorin e energjisë.

Ky projekt pritet ta lehtësojë tranzicionin e energjisë të

udhëhequr nga Qeveria e Kosovës, duke krijuar mundësinë që fuqia punëtore që fitojnë shkathhtësinë e kërkuara, njëherësh të ofrohet asistencë teknike për punëdhënësit në fushën e energjisë dhe në këtë mënyrë, të rritet edhe përfaqësimi i grave në këtë sektor.

Me këtë rast, ministria Rizvanolli ka theksuar se tekta ndërtojmë kapacitete për ruajtjen e energjisë në njërin anë, e kapacitete të reja për gjenerim të energjisë në anën tjetër, është tejet e rëndësishme të sigurohemi që kemi fuqi punëtore të shkathtë e gjithëpërfshirëse, për t'i realizuar e mirëmbajtur ato me sukses.

Ajo, po ashtu, ka kujtuar se sektori i energjisë, ekonomia dhe shoqëria jonë janë vetëm të forta aq sa janë edukimi dhe trajnimi i fuqisë sonë punëtore. "Ato mund



të jenë të forta dhe të drejta, vetëm nëse të gjithë kontribuojnë në mënyrë aktive me aftësitë, njohuritë dhe idetë e tyre, gjithashtu përfaqësohen dhe përfitojnë nga zhvillimi ekonomik në mënyrë të barabartë", ka

theksuar Rizvanolli. Projekti "Jeta" është pjesë e Programit Kompakt me MCC-në, i cili është projekti më i rëndësishëm i energjisë, ku përmes këtij projekti Kosova do të ketë rezerva të energjisë përmes baterive të

kapacitetit prej 340 MWh. Programi Kompakti ka vlerën e 236.7 milionë dollarësh, janë 202 milionë dollarë janë grant i fituar nga qeveria amerikane dhe 34.7 milionë dollarë të dedikuara nga Qeveria e Kosovës.

## Rritja e kërkesës për rrymë 'do t'i mbajë gjallë termocentralet me thëngjill'



PRISHTINË, 19 KORRIK - Kërkesa për rrymë në botë është duke shënuar rritjen më të shpejtë në gati 20 vjet për shkak të përdorimit të kondicionerëve si pasojë e rritjes së temperaturave, ka thënë Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë në një raport të publikuar të premten. Sipas gjetjeve, ky trend, që pritet të vazhdojë edhe më 2025, nënkupton vazhdimësinë e përdorimit të energjisë me thëngjill, ndonëse do të rriten kapacitetet e energjisë së ripërtërishme. Shumë vende në botë janë duke regjistruar temperature rekorde dhe valë të të nxehtit. Rritja e konsumit global të energjisë

pritet të shkojë në gati 4 për qind më 2024 - më e madhja prej vitit 2007.

Rritje e njëjtë është parashikuar edhe për vitin 2025, në krahasim me 2.5 për qind të rritjes së kërkesës më 2023.

India pritet të jetë lidere në këtë aspekt, e pasuar nga Kina.

Në gjetjet e raportit është përmendur që në këtë periudhë do të rriten edhe kapacitetet për energji të ripërtërishme dhe që kjo energji ta tejkalojë atë me thëngjill më 2025. Megjithatë, mënyrat për prodhim të energjisë që shkaktojnë më shumë ndotje, siç është ajo me thëngjill, do të vazhdojnë të jenë të qëndrueshme, sidomos në Kinë.

## Problemi global i sigurisë kibernetike prek edhe KESCO-n

PRISHTINË, 19 KORRIK - "Të nderuar konsumatorë, për shkak të një kolapsi kibernetik, i cili ka prekur shumë sektorë në shumë vende të botës, ka afektuar edhe Kosovën ku, nga mëngjesi i sotëm, të gjitha kërkesat tuaja po hasin në vështirësi t'i procesojmë te departamentet përkatëse për

shkak të rënies së sistemit të IT-së", ka njoftuar KESCO. Sistemi i Sigurisë Kibernetike "CrowdStrike Global" ka lajmëruar opinionin e gjerë për një gabim në sistemin e tyre. "Rrjedhimisht, ky problem nuk është specifik në KESCO, por është problem që ka afektuar të gjitha kompanitë e mëdha globale.

Ekipet përkatëse janë në kontakt me kompanitë botërore, si Microsoft, CrowdStrike Global etj. dhe po punohet në zgjidhjen e këtij problemi. Kërkojmë mirëkuptimin tuaj, dhe shpresojmë që së shpejti të gjitha kërkesat tuaja do të procesohen", ka njoftuar KESCO.






# “Ekranu blu i vdekjes”. Çfarë e shkaktoi kaosin global

Në bazë të problemit global në sistemet kompjuterike qëndron një përditësim i dështuar i softuerit antivirus CrowdStrike, i cili ka nxjerrë jashtë funksioni pajisjet Microsoft

Sot në mëngjes bota u zgjua në kaos për shkak të një problemi kompjuterik që paralizoi sistemet e komunikimit të aeroportëve, bankave, mediave dhe çdo platforme që përdor pajisje Microsoft. Gjigandi global i IT-së raportoi se ka vënë në zbatim “masa zbutëse”, që nuk do të thotë se janë gjetur zgjidhje, por se sistemet e urgjencës janë vënë në funksion për të anashkaluar problemin ndërsa pritet një zgjidhje përfundimtare. Problemi themelor mund të ketë lindur për shkak të softuerit antivirus i krijuar nga palë të treta, prodhuar nga CrowdStrike, i cili nisi një përditësim gjatë natës, që megjithatë, për arsye që mbeten për t’u verifikuar, shkoi keq, duke shkaktuar daljen jashtë funksioni të sistemeve të Microsoft.

Ekspertët raportuan këtë si shkakun kryesor, i cili është edhe baza e të ashtuquajturit “ekrani blu i vdekjes”, ekranu blu tipik që shfaqet kur ka një problem të rëndë të sistemit, i cili nuk mund të anashkalohe në asnjë mënyrë. Megjithatë, ekspertët nuk janë ende të sigurt se problemet e CrowdStrike dhe ato të Microsoft janë të lidhura drejtpërdrejt dhe nuk mund të përjashtohet, edhe nëse mundësitë janë të pakta, që këto janë dy probleme shoqëruese, por jo të lidhura drejtpërdrejt. Sipas transmetuesit britanik Sky News, në një mesazh telefonik të regjistruar,



CrowdStrike thotë se është në dijeni të problemeve në sistemin operativ Windows të Microsoft-it në lidhje me sensorin e tij Falcon. Ndërkohë problemet pasojnë njëra-tjetrën dhe akumulohen. Në spitalet amerikane dosjet mjekësore të pacientëve janë të

bllokuara dhe nuk mund të konsultohen nga mjekët, ndërsa në Gjermani dy spitale kanë bllokuar operacionet për të njëjtën arsye. Sistemi i transportit ajror është në vështirësi serioze, me shumë aeroporte të mbyllura për trafikun ajror. Në Evropë, ato që po

vuajnë më shumë pasoja janë Berlina dhe Amsterdami, të cilët janë gjithashtu dy nga aeroportet më të rëndësishme për tregtinë ndërkontinentale. Kompania KLM ka vendosur të ndalojë të gjithë avionët e saj ndërsa Delta dhe American

Airlines kanë raportuar probleme serioze. Aeroporti Narita në Japoni gjithashtu ka ndërprerje. Në Indi, në aeroportin e Delhi, janë rikthyer në përdorimin e dërrasave të zeza për të treguar se fluturimet dhe biletat janë shkruar me stilolaps.

## Paralajmërimi: E ardhmja e Ballkanit, nëse Trump fiton zgjedhjet amerikane

“Kthimi i Trump dhe përfshirja e reduktuar e SHBA-së në Ballkanin Perëndimor do të inkurajonte gjithashtu Beogradin të vazhdojë hegemoninë e tij rajonale.

Nëse dhuna ndodh në një nga vendet e shënjestruar nga regjimi i Vuçicit, BE-ja nuk mund të llogaritet që të ndërhyjë dhe të mbrojë pavarësinë e Kosovës, Bosnjen apo Malin e Zi. Prandaj është thelbësore që të tre vendet të zgjerojnë mbrojtjen e tyre në përgatitje për konflikt të armatosur, pasi kthimi i Trump do të dobësonte rolin global të Amerikës dhe do të inkurajonte të gjitha diktaturat ekspansioniste që të përshpejtojnë ambicet e tyre”.

Kështu pohon analisti dhe njohësi amerikan i Ballkanit, Janusz Bugajski, në një intervistë që ka dhënë për Pobjeda nga Podgorica. Si bashkëpunëtor i lartë i Fondacionit Jamestown nga Uashingtoni, ai ka paralajmëruar prej vitesh për ndikimin malinj rus në rajon dhe beson se Ballkani do të marrë sërish zjarr nëse Donald Trump fiton zgjedhjet amerikane në nëntor.

“Është shumë herët për të nxjerrë përfundime për ndikimin që do të



ketë atentati ndaj Trump në zgjedhjet e nëntorit. Duke pasur parasysh polarizimin

e Amerikës, shumica e qytetarëve tashmë kanë vendosur se për kë do të votojnë. E vetmja e panjohur

është madhësia e pjesëmarrjes dhe shtesa e të pavarurve dhe centristëve që mund të lëvizin

drejtpërdrejt ose Bidenit në katër ose pesë shtete kyçe të fushëbetesës.

Nëse Trump fiton, ai duket i vendosur të adoptojë një politikë të jashtme më izoluese dhe të jetë edhe më pak i gatshëm se Biden për të sfiduar ambicet serbe në Ballkanin Perëndimor.

Në një skenar të tillë, presione në rritje që mund të rezultojnë në konflikte të reja të armatosura në rajon”, tha Bugajski, duke përfunduar:

“Trump e admiron Putinin dhe i ka zili fuqitë e tij diktatoriale në Rusi. Komentet e tij nënvizojnë se Evropa nuk mund të mbështetet më automatikisht në SHBA dhe nuk është e përgatitur ushtarakisht për luftë të hapur me Moskën. Pa praninë amerikane, niveli i ulët i pajisjeve dhe aftësitë e kufizuara operacionale të Evropës do të bëheshin të qarta. Ndërsa forcat e armatosura evropiane janë zvogëluar nga 3.4 milion në 1989 në 1.3 milion në 2022, riarmatimi gjithëpërfshirës është i nevojshëm. Të paktën 100 miliardë euro do të nevojiten deri në vitin 2025 për të rritur prodhimin e armëve dhe për të penguar ose mposhtur një sfidë të mundshme ruse”.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

# Sport



## Nëna e Mbappes: Djali im gjithmonë ka ëndërruar të luajë për Real Madridin

PARIS, 19 KORRIK - Nëna e Kylian Mbappe ka thënë se ka qenë gjithmonë ëndrra e djalit të tij të luajë në Real

Madrid. Kujtojmë se francezi ka zbarkuar në fillim të kësaj jave në stadiumin "Santiago Bernabeu" pasi ka

nënshkruar një marrëveshje me klubin këtë verë nga Paris Saint-Germain (PSG). Në një bisedë me "Le Parisien", nëna

e Mbappes ka thënë se djali i tij ishte në kontakt prej kohësh me presidentin e Real Madridit, Florentino Perez.



## Nisin garat 'FIBA 3x3 Challenger' në Prishtinë

PRISHTINË, 19 KORRIK - Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë kanë nisur garat e basketbollit "FIBA 3x3 Challenger". Në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare sportive janë duke marrë pjesë 18 shtete nga mbarë bota. Garat janë duke u zhvilluar dy konkurrenca, edicioni i tretë për meshkuj dhe edicioni i dytë për femra. Ndeshjet kanë filluar me edicionin e dytë "FIBA 3x3 Women's Series". Gara është hapur me ndeshjen në mes të Kosovës dhe Polonisë, ndërsa të

premtën janë zhvilluar ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale, për të vazhduar pastaj edhe për dy ditë të tjera me "Men Challenger categories". Në hapjen e kësaj ngjarjeje kanë marrë pjesë kryeministri Albin Kurti, zëvendësministria Daulina Osmani, Fisnik Juniku nga "3x3 Prishtina", përfaqësues të klubeve pjesëmarrëse, basketbollistë dhe sportdashës të basketbollit. "FIBA 3x3 Challenger" është mbështetur nga Ministria e Sportit.



## Universiteti i Prishtinës, triumfues në kampionatin evropian universitar



PRISHTINË, 19 KORRIK - Ekipi i karateistëve të Universitetit të Prishtinës, i përbërë nga Fortesa Orana, Vlera Qerimi dhe Elmedina Istogu, ka rrëmbyer vendin e parë në Kampionatin Evropian Universitar të mbajtur në Hungari. Karateistet tona kanë mposhtur ekipet nga Azerbajxhani, Hungaria dhe në finale Turqinë, duke u renditur kështu në krye

të kësaj gare. Vajzat e UP-së kanë shkëlqyer edhe në garat individuale. Karateistja Fortesa Orana ka fituar medaljen e argjendtë në kategorinë Kumite +68 kg, si dhe Vlera Qerimi ka fituar medaljen e argjendtë në kategorinë Kumite -68kg. Ndërsa me medalje të bronzte u shpërblye Elmedina Istogu, e cila garoi në kategorinë Kumite -

61kg. Fortesa, Vlera dhe Elmedina gjatë garave të tyre kanë mposhtur kundërshtarët nga Turqia, Austria, Gjermania, Bosnjë-Hercegovina, Rumania, Sllovakia dhe Mali i Zi. Pjesëmarrja e Kosovës në këto lojëra është mundësuar në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës dhe Federatën e Karatesë të Kosovës.

## Papa Françesku: Lojërat Olimpike janë mundësi për unitet në Francë

ROMË, 19 KORRIK - Papa Françesku ka thënë të premtën se Lojërat Olimpike do të mund të ofrojnë mundësi për unitet kombëtar në Francë. Ai i ka bërë këto deklaratë pak para nisjes së këtyre Lojërave në Paris më 26 korrik. "Shpresoj që organizimi i këtyre Lojërave do të jetë mundësi për të gjithë njerëzit në Francë që të kenë

harmoni, të kalojnë përtej dallimeve dhe opozitës, dhe të lejohet forcimi i unitetit të kombit", ka thënë Papa përmes një letre. Thirrja e tij vjen në kohën e dallimeve të theksuara në politikën franceze, me që zgjedhjet e kanë lënë vendin pa një rrugë të qartë për formim të qeverisë.

Në thirrjen e Papës janë përsëritur thirrjet për arritjen e armëpushimeve në botë, në kohën e mbajtjes së Lojërave, të cilat i ka përshkruar si organizim "që natyrshëm sjell paqe dhe jo luftë". Lojërat Olimpike do të përfundojnë më 11 gusht. Këtë vit Kosova përfaqësohet me nëntë sportistë.



## Alvaro Morata transferohet në Milan

MILAN, 19 KORRIK - AC Milani ka njoftuar se ka nënshkruar kontratë me Alvaro Moratan e Atletico Madridit. Kapiteni i kombëtares spanjolle, me të

cilën së fundi ka fituar Kampionatin Evropian, Morata ka nënshkruar me kuqezinjët deri më 30 qershor 2028, me opsion për ta

vazhduar edhe për një vit shtesë. Kapiteni aktual spanjoll ka luajtur 80 ndeshje për ekipin e tij kombëtar, duke shënuar 36

gola dhe ka fituar kampionatin e fundit evropian dhe Ligën e Kombeve UEFA 2022/23. Ai ka zgjedhur ta veshë numrin 7.







# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Emine Hoti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811497769 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Law Firm Consulting E Hoti” D.O.O. od Gnjilane, sa vlasnikom Emine Hoti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811497769 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Emine Hoti, has come to the decision to quit its business: 811497769 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enis Lahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.

- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.

- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale “Bahri Haxha”-ish shkolla e mesme “Muharrem Bekteshi”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







# TRADITË QË NGA

# 1992

